

Konform nenit 15, të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 2003/14, dhe të Udhëzimit Administrativ nr-54/2005, datë 10.05.2005 si dhe nenit 12 alineja 1 dhe 2 dhe të nenit 17 alineja 1 pika b të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 25 alineja 4 pika (b) dhe të nenit 27 alineja 1 të Statutit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 29 shkurt 2012, mori këtë:

## **V E N D I M I**

### **PER MIRATIMIN E PLANIT RREGULLUES URBAN NE VENDIN E QUAJTUR "BOKA" TË QYTETIT TË PRIZRENIT**

#### Neni 1

Me këtë Vendim bëhet miratimi i PRRU-së për vendin e quajtur "Boka" në qytetin e Prizrenit, me të cilin parashihen troje për ndërtim të objekteve individuale, ndërtimi objekteve me karakter arsimor, objekte me karakter rekreativ-sportiv (poligoni gjuetie, stadiumi i qytetit etj.), si dhe objekte të tjera për nevojat e KK-Prizren, e cila është hartuar nga byroja projektuese "DIARKO,, sh.p.k. nga Prizreni (bartës i hartimit të planit), e hartuar konform Ligjit mbi Planifikim Hapësinor nr.2003/14, datë 03.07.2003.

Pjesë përbërëse e këtij PRRU-së do të jetë elaborati me të gjitha shtojcat grafike dhe tekstuale.

Pjesa tekstuale përmban:

- kushtet për rregullimin dhe destinimin e ndërtimit në këtë hapësirë.

Pjesa grafike duhet të përmbajë:

- paraqitjen grafike të Planit Rregullues Urban.

#### Neni 2

Planini Rregullues Urban për lokacionin „**BOKA**” të qytetit të Prizrenit, përfshinë lokacionin që ndodhet në ngastrat kadastrale nr-800/1, 800/2, 801/1, 68/1, 688/2, 694, 689, 697, 760, 756, 757, 759, 532, dhe 3429 e që përfshinë një sipërfaqe prej 78 hektarësh e 75 ari, e cila do të inkurajojë, strategjinë zhvillimor të Komunës së Prizrenit për periudhën 5 vjeçare.

#### Neni 3

Me Planin nga neni 1 i këtij Vendimi do të planifikohet zgjidhja e hapësirës në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale për zhvillimin e ardhshëm të Prizrenit, me qëllim që t'ju mundësojë qytetarëve jetën në një qytet me planifikim urban dhe kushte të sigurta për investim.

#### Neni 4

Ky Vendim bashkë me dokumentacionin e përshkruar në nenin 1, dhe 2 të këtij Vendimi do të jetë pjesë përbërëse e Planit Zhvillimor Urban të qytetit të Prizrenit

#### Neni 5

Plani Rregullues Urban hartohet për periudhën kohore më së paku 5 (pesë) vjeçare, ndërsa për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe do te shpallet ne tabelën e shpalljeve publike.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENTIT  
Kuvendi i Komunës  
Nr. 01/011-2339  
Më 29 shkurt 2012  
Prizren



Kryesuesi i Kuvendit  
Nijazi Kryeziu